

Qielli i vendeve evropiane dhe i Turqisë do të mbyllet për aeroplanët rusë, ka njoftuar Ministria ruse e Mbrojtjes.

Për shkak të kësaj, pilotët rusë të cilët kryejnë detyrat në luftë në Siri, kanë qenë të detyruar që të sillen përreth Evropës, transmeton Republika.info.

“Olenegorsk është aeroporti ynë më bashkëkohor, që neve na mundëson bartjen e pajisjeve dhe mbushjen me karburant në ajër. Ka pasur momente të caktuara të cilët kanë pamundësuar realizimin alternativ të detyrave. Megjithatë, Evropa dhe Turqia ata (aeroplanët) nuk i ka lejuar”, ka thënë gjeneralmajori rus, Anatolij Kononov.